

POLITIKA E PRIVATËSISË SË BBSH **në lidhje me përdorimin e faqes zyrtare të internetit**

PARATHËNIE

Kjo politikë privatësie përcakton praktikat e përpunimit të të dhënave që zbatohen në përdorimin e faqes së internetit të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë (BBSH). Deklarata duhet të lexohet së bashku me Termat dhe Kushtet e Përdorimit.

Banka e Bashkuar e Shqipërisë (BBSH) është e angazhuar ta mbajë të fshehtë informacionin në lidhje me përdoruesit e faqes së saj zyrtare. Është e domosdoshme që përdoruesit t'i kuptojnë plotësisht termat dhe kushtet që lidhen me martjen dhe përdorimin e informacionit që ne mbledhim dhe si e përpunojmë atë.

Banka e Bashkuar e Shqipërisë (BBSH) është zotëuesi i vetëm i informacionit dhe të dhënave që mbledhet nëpërmjet faqes zyrtare www.uba.com.al. Banka e Bashkuar e Shqipërisë (BBSH) nuk do ta shesë, ndaje, ose japi në përdorim informacionin tek palët e tjera.

Ky informacion do të përdoret vetëm nga Banka e Bashkuar e Shqipërisë (UBA) për administrimin teknik të faqes zyrtare internetit, administrimin e klientëve dhe kërkimin dhe zhvillimin.

LIDHJA

Faqja zyrtare e Bankës së Bashkuar të Shqipërisë (BBSH) mund të aksesohet ose mund të lejoj aksesin në faqet e tjera të internetit.

Banka e Bashkuar e Shqipërisë (BBSH) nuk është përgjegjëse për praktikat e privatësisë ose përmbajtjen e faqeve të tjera. Kjo politikë privatësie zbatohet vetëm për informacionin e mbledhur nga faqja zyrtare e internetit të BBSH. Ne inkurajojmë përdoruesit tanë që të jenë të vetëdijshëm që, kur largohen nga faqja zyrtare e BBSH www.uba.com.al, të lexojnë politikën e privatësisë të çdo dhe secilës faqe që mbledh dhe përpunon informacion që identifikon individin.

MBLEDHJA E INFORMACIONIT

Banka e Bashkuar e Shqipërisë (BBSH) mbledh dhe përpunon vetëm ato të dhëna personale të klientëve dhe/ose të të tretëve me të cilët banka hyn në marrëdhënie kontraktuale gjatë kryerjes së aktivitetit të saj dhe që janë të domosdoshme për realizimin e veprimtarive për të cilat është liçensuar nga Banka e Shqipërisë, ose për përmbushjen e funksioneve të saj si subjekt ligjor tregtar.

Faqja jonë zyrtare e internetit nuk ofron mundësinë për regjistrim. Ju mundeni vetëm të shihni informacionin që ne publikojmë në të. Duke vizituar faqen tonë të internetit, ju lejoni vullnetarisht dhënien dhe përpunimin e informacionit të mëposhtëm:

1. Informacion që identifikon individin:

Përdoruesit lejojnë dhënien e të dhënave të mëposhtme:

- Informacion mbi kërkimet që kryeni;
- Informacion mbi vizitat në faqen e BBSH.

Duhet të mbahet parasysh që nuk merret informacioni i dhënë nga vizitprët e tjerë të faqes

2. Informacioni i cili nuk lejon identifikimin e individit:

Kur ju përdorni faqen zyrtare të internetit, mblidhet informacion me karakter teknik. Informacioni me karakter teknik që mblidhet përfshin: llojin e programit të kërkimit (broëser) që po përdorni, mënyrën si jeni lidhur në internet, adresën tuaj të protokollit në internet (që është adresa e internetit të kompjuterit tuaj, të cilën e shfaqin të gjithë kompjuterat automatikisht sa herë që hyni në rrjet ose në kompjutera të tjerë), etj. Prandaj, informacioni që mblidhet gjurmon mënyrat e trafikut të rrjetit të përdoruesit dhe nuk gjurmon përdoruesit individualë.

METODA E MBLEDHJES SË INFORMACIONIT

Informacioni juaj mund të ruhet në mënyrën e mëposhtme:

“Cookies”

Këto janë skedare me tekste shumë të vogla të vendosura në njësinë tuaj qendrore nga një server i faqes. “Cookies” funksionojnë si karta identifikuese që informojnë serverin se ju jeni visitor përsëritës i faqes. Ato mund të lexohen vetëm nga serveri që ju merrni informacionin dhe ju jeni unik për kompjuterin tuaj. Nëse ju preferoni, ju mund ta programoni programin e kërkimit tuaj (broëserin) që t’i refuzojë “cookies”. Megjithatë, nëse e bëni këtë, ju nuk e shfrytëzoni dot plotësisht një faqe kërkimi. Gjithashtu ju mund ta programoni programin e kërkimit (broëser) që t’ju njoftojë kur merrni “cookies”, duke ju dhënë mundësinë të vendosni nëse doni t’i pranoni apo jo.

Në të kundërt ju mund të mos aktivizoni “cookies” duke ndryshuar programin e kërkimit (broëser) tuaj.

PËRDORIMI I INFORMACIONIT

Informacioni i mbledhur përdoret kryesisht për sa vijon:

- Për të përdorur faqen;
- Për të kryer kërkime mbi përdorimin e faqes;
- Për të mësuar rreth shpërndarjes gjeografike të vizitorëve në faqen tonë zyrtare.

Banka e Bashkuar e Shqipërisë (BBSH) mund të përdorë agjentët dhe kontraktuesit për të ndihmuar në administrimin e rrjetit. Nëse këta agjentë dhe kontraktues kanë akses në informacionin që identifikon personin, ata janë të detyruar ta mbrojnë këtë informacion në një mënyrë që perputhet me këtë Politikë Privatësie, si psh: të mos e përdorin informacionin për asnjë qëllim të ndryshëm nga ai i kryerjes së shërbimeve që po kryejnë për mirëfunksionimin e rrjetit.

Çështje ligjore: Faqja e BBSH nuk do i japë të dhënat tuaja personale palëve të treta, vetëm në rastet kur një gje e tillë kërkohet nga ligji ose gjykata. Mos-respektimi i këtyre kërkesave mund ta ekspozonte BBSH ndaj sanksioneve ligjore.

Të dhënat personale të mbledhura nga bankat mbahen për periudhat si më poshtë:

- a) Në përfundim të marrëdhënies financiare, të dhënat e klientit bllokohen në bazën e të dhënave. Ky bllokim passjell pamundësinë që këto të dhëna të shikohen dhe përpunohen nga operatorët bankarë. Këto të dhëna mund të shikohen vetëm nga persona me status të veçantë dhe vetëm me miratim të autoritetit më të lartë të bankës, apo strukturës së autorizuar posaçërisht prej tij;
- b) Të dhënat personale të klientëve mbahen deri në pesë vjet pas datës së përfundimit të marrëdhënies financiare me klientin. Në përfundim të periudhës së pesë vjeçare banka fshin këto të dhëna nga skedarët dhe nga sistemi kompjuterik dhe fizik;

- c) Nëse, në bazë të legjislacionit shqiptar në fuqi, një autoritet apo institucion i përligjur, urdhëron mbajtjen e këtyre të dhënave përtej afatit pesë vjeçar, të dhënat kopjohen në një bazë të dhënash të veçantë, masat e sigurisë dhe periudha e mbajtjes së të cilit do të bëhen në përputhje me ligjin, në bazë të të cilit autoriteti kërkon mosfshirjen e të dhënave.

ZGJEDHJA JUAJ

Përdorimi i faqes zyrtare është vetëm në zgjedhjen tuaj.

TË DREJTAT E SUBJEKTIT TË TË DHËNAVE

1. E drejta për akses

Çdo person ka të drejtë që, me kërkesë me shkrim, të marrë nga BBSH:

- konfirmimin nëse të dhënat personale po i përpunohen ose jo, informacion për qëllimin e përpunimit, për kategoritë e të dhënave të përpunuara dhe për marrësit e kategoritë e marrësve, të cilëve u përhapen të dhënat personale;
- në një formë të kuptueshme, të dhënat personale dhe informacionin e disponueshëm për burimin e tyre.

Informacioni për të dhënat komunikohet në formën, në të cilën ishin në kohën kur është bërë kërkesa.

BBSH, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së kërkesës, informon subjektin e të dhënave ose i shpjegon atij arsyet e mosdhënies së informacionit.

E drejta për akses ushtrohet në përputhje me parimet kushtetuese të lirisë së shprehjes dhe informacionit, lirisë së shtypit dhe sekretit profesional dhe mund të kufizohet, nëse cenon interesat e sigurisë kombëtare, politikën e jashtme, interesat ekonomikë dhe financiarë të shtetit, parandalimin dhe ndjekjen e veprave penale.

Në rast se aksesimi mohohet, duke argumentuar se cenohen interesat e sigurisë kombëtare, politika e jashtme, interesat ekonomikë dhe financiarë të shtetit, parandalimi dhe ndjekja e veprave penale ose liria e shprehjes dhe informimit apo liria e shtypit, subjekti i të dhënave mund t'i kërkojë komisionerit të kontrollojë përjashtimin në rastin konkret. Komisioneri informon subjektin e të dhënave për masat e marra.

2. E drejta për të kërkuar korrigjimin ose fshirjen

- Çdo subjekt i të dhënave ka të drejtë të kërkojë korrigjimin ose fshirjen e të dhënave, kur vihet në dijeni se të dhënat rreth tij nuk janë të rregullta, të vërteta, të plota ose janë përpunuar dhe mbledhur në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji;
- BBSH brenda 30 ditëve nga data e marrjes së kërkesës së subjektit të të dhënave, duhet ta informojë atë për përpunimin e ligjshëm të të dhënave, kryerjen ose moskryerjen e korrigjimit apo të fshirjes;
- Kur BBSH nuk bën korrigjimin ose fshirjen e të dhënave të kërkuara prej tij, subjekti i të dhënave ka të drejtë të ankohet te komisioneri.

3. E drejta e subjektit të të dhënave për të kundërshtuar

- Subjekti i të dhënave ka të drejtë të kundërshtojë, në çdo kohë, mbështetur në ligj, përpunimin e të dhënave rreth tij, sipas shkronjave "a" dhe "b" ne vijim, përveç kur parashikohet ndryshe me ligj:
 - për kryerjen e një detyre ligjore me interes publik ose ushtrimin e një kompetence të BBSH ose të një pale të tretë, së cilës i janë përhapur të dhënat;

- b) për ndjekjen e interesave legjitimë të BBSH ose të një pale të tretë, së cilës i janë përhapur të dhënat, përveç kur këta interesa mbizotërojnë mbi interesat për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive themelore të subjektit të të dhënave.
2. Subjekti i të dhënave ka të drejtë t'i kërkojë BBSH të mos fillojë ose, nëse përpunimi ka filluar, të ndalojë përpunimin e të dhënave personale, që lidhen me të, për qëllime të tregtimit të drejtpërdrejtë.

4. E drejta për t'u ankuar

- a) Çdo person, që pretendon se i janë shkelur të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm për të dhënat personale, ka të drejtë të ankohet ose të njoftojë komisionerin dhe të kërkojë ndërhyrjen e tij për vënien në vend të së drejtës së shkelur. Pas këtij ankimi, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, subjekti i të dhënave mund të ankohet në gjykatë;
- b) Në rast se subjekti i të dhënave ka bërë ankim, BBSH nuk ka të drejtë të ndryshojë të dhënat personale deri në dhënien e vendimit përfundimtar.

NDRYSHIMET E POLITIKËS SË PRIVATËSISË

Kjo politikë privatësie përcakton praktikat dhe politikat tona aktuale. Nëse praktikat tona do të ndryshojnë në të ardhmen, kjo politikë do të ndryshojë dhe do të publikohet, në mënyrë që ju të keni informacionin më të fundit mbi politikat tona të përdorimit dhe mbledhjes së të dhënave.

Si mund të na KONTAKTONI?

Nëse keni ndonjë pyetje ose shqetësim rreth Politikës sonë të Privatësisë për përdorimin e faqes zyrtare të BBSH-së, ju ftojme të na kontaktoni në mënyrat si më poshtë listuar:

Departamenti i IT-së
Banka e Bashkuar e Shqipërisë
Departamenti i Informacionit dhe Teknologjisë

Adresa:

Zogu i Zi, Godina 14 kate “Teknoprojekt”

P.O. Box 128, Tirana, Albania

Tel: +355 4 2404575/ ext. 111; Fax: +355 4 240 45 58; E-mail: info@uba.com.al